



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primjenj / Prodato Received / Delivery	23.08.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojça Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHACK	4934/2022		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.612/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtar dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.612/2022 të datës 12.07.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 23.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.612/2022 e datës 12.07.2022 e parashtruar nga ankuesja
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.13-112/12-0053804/22 i datës 04.07.2022 i Komisionit të Pranimit të Komunës së Podujevës dhe Njoftimi me numër Nr.13-111/01-0050732/22 i datës 24.06.2022 i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Podujevës.

A r s y e t i m

Komuna e Podujevës duke u bazuar në dispozitat e nenit 38 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publike dhe të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, fillimisht me datën 27.05.2022 ka njoftuar lidhur me konkursin, ndërsa me datën 13.06.2022 ka shpallur konkursin RN00009111 për lëvizje brenda kategorisë lidhur me pozitën “Zyrtar për shërbim me qytetarë”, për klasën e pozitës Profesional 3.

Pas verifikimit paraprak nga ana e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Rahovecit, ankuesja është njoftuar se është përfshirë në listë të shkurtër dhe se intervista me gojë mbahet me datën 24.06.2022. Në bazë të vlerësimit nga Komisioni i Pranimit ankuesja në intervistën me gojë,

sipas formularit të renditjes përfundimtare të kandidatëve nga ky proces i pranimit ka marrë gjithsejtë 50.8 pikë.

Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Podujevës me datën 24.06.2022 ka publikuar njoftimin për përfundimin e procedurës së rekrutimit për lëvizje brenda kategorisë për pozitën "Zyrtar për shërbim me qytetar" në Drejtorinë e Administratës, pa fitues për shkak se kandidatja nuk ka arritur ti marrë 60 (gjashtëdhjetë) pikë .

Ankuesja kundër këtij vlerësimi me datën 28.06.2022 ka parashtruar ankesë tek Komisioni i Pranimit të Komunës së Podujevës. Komisioni i Pranimit me datën 04.07.2022, ka nxjerrë Vendimin me Nr.13-112/12-0053804/22, sipas të cilit ka refuzuar ankesën e ankueses me arsyetimin se e njëjta ka marrë 50.8 pikë, e që nuk kanë qenë të mjaftueshme për emërim në pozitën përkatëse, duke konstatuar që edhe pas ankesës së ankueses mban të njëjtin qëndrim.

E pakënaqur me Njoftimin me Nr.13-111/01-0050732/22 të datës 24.06.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës, me datën 12.07.2022 ka parashtruar ankesën me numër protokolli 4038/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së dispozitave procedurale dhe shkeljes së dispozitave materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës konform dispozitave të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 13.07.2022 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Rahovecit, ndërsa me datën 21.07.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Rahovecit me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses me Nr.Prot:4038/2022 të datës 12.07.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Dosjen e ankueses së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës si dhe formularët e vlerësimit; Kopjen e konkursit të datës 13.06.2022 me numër RN00009111; Njoftimin me numër Nr.13-111/01-0050732/22 të datës 24.06.2022 për përfundimin e procedurës së rekrutimit; Vendimin me numër Nr.13-112/12-0053804/22 të datës 04.07.2022 nga Komisioni i vlerësimit; Njoftimin me numër Nr.13-170/2022 të datës 22.06.2022 lidhur me listën e ngushte; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 13.07.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 21.07.2022 nga Komuna e Podujevës lidhur me shkresat e bashkëngjitura të lëndës; Listën e aplikantëve me numër të referencës RN00009111; Njoftimin me numër Nr.13-169/2022 të datës 22.06.2022; Aplikacionin me numër RN00009111 të datës 13.06.2022 të ankueses; Formularët e vlerësimit individual të kandidatëve për vendin e punës lidhur me intervistën me gojë të datës 24.06.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses **është e pabazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pasi , ka analizuar situatën juridike lidhur me atë se ankuesja në ankesën e saj të parashtruar në Këshill e atakon Njoftimin me numër Nr.13-



111/01-0050732/22 të datës 24.06.2022 i lëshuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Podujevës lidhur me përfundimin e procedurës së rekrutimit /Lëvizje brenda kategorisë për pozitën "Zyrtar për shërbim me qytetar", e jo Vendimin Nr.13-112/12-005384/22 e fundit të datës 04.07.2022 të Komisionit të Vlerësimit lidhur me refuzimin e ankesës së saj, ka konstatuar se çështja e cila atakohet me ankesën e ankueses ndërlidhet me çështjen kryesore të trajtuar edhe nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Komunës së Podujevës, andaj edhe me rastin e vendimmarrjes, Kolegji ka pasur parasysh situatën e cila edhe ka qenë objekt shqyrtimi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha provat në shkresat e lëndës, ka konstatuar se Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Podujevës bazuar në nenin 45 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, fillimisht ka bërë verifikimin paraprak të kandidatëve për këtë pozitë, duke përfshirë në listën e ngushtë vetëm ankuesen si kandidatën e vetme që ka aplikuar dhe i ka plotësuar kushtet e konkursit. Kolegji, pasi i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses dhe duke u bazuar në të gjitha provat e lëndës, konstaton se Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Podujevës procedurën e pranimit për lëvizje në kategori lidhur me pozitën "Zyrtar për shërbim me qytetarë", e ka bërë në pajtim me nenin 38 të Ligjit Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë si dhe nenin 46, 47 dhe 48 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Pas përfundimit të procedurave të pranimit, vlerësimit paraprak, vlerësimit të intervistës me gojë dhe vlerësimit të jetëshkrimit siç parashihet me nenin 16 paragrafin 2 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ankuesja nga ky proces është vlerësuar me pikë të përgjithshme prej 50.8 pikë, e si rrjedhojë nën 25 paragrafi 2 i Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përcakton se: *"Kandidatët që janë vlerësuar me shtatëdhjetë (70) pikë e më shumë, janë kandidatë fitues. Njësia Përgjegjëse publikon listën e kandidatëve fitues në pajtim me nenin 9 të kësaj Rregulloreje"*, në rastin konkret meqenëse ankuesja në të gjitha fazat nga Komisioni i Pranimit është vlerësuar me pikë të përgjithshme prej 50.8 pikë, atëherë sipas nenit 25 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përcaktohet se: *"Nëse asnjë nga kandidatët nuk është vlerësuar së paku me shtatëdhjetë 70 pikë, Komisioni i Pranimit, harton dhe miraton aktin e përfundimit të procedurës të konkurimit pa fitues. Njësia Përgjegjëse publikon njoftimin për përfundimin e procedurës të konkurimit pa fitues, në pajtim me nenin 9 të kësaj Rregulloreje"*.

Bazuar në këtë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, referuar dispozitave të lartcekura lidhur me emërimin në një pozitë në shërbimin civil, konstaton se për t'u emëruar në një pozitë profesionale në shërbimin civil nevojiten së paku 70 pikë, andaj meqenëse ankuesja nuk i ka fituar 70 pikë të vlefshme për tu emëruar, atëherë edhe emërimi i saj për lëvizje brenda kategorisë lidhur me pozitën "Zyrtar për shërbim me qytetarë" për klasën e pozitës Profesional 3, në Komunën e Podujevës është bërë i pamundur, kështu që pretendimi ankimor i ankueses së njëjta nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë nga ana e komisionit, është pretendim i pabazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Vendimi me numër Nr.13-112/12-0053804/22 i datës 04.07.2022 i Komisionit të Pranimit të Komunës së Podujevës dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, po ashtu edhe Njoftimi me numër Nr.13-

111/01-0050732/22 i datës 24.06.2022 i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Podujevës është në pajtim me nenin 25 paragrafi 3 dhe 4 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, kështu që pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuara.

Duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda,A.nr.612/2022, datë 23.08.2022.

Ardita Perçuku-Shyti



Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Podujevës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

